



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 18.09.2018

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR
RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË
AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 18.09.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Damian Gjijnuri dhe përfaqësues të kësaj ministrie si dhe zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë z. Erjon Luçi dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 81, pika 1, 83 pikat 1 e 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan, në shumën prej 16 000 000 USD-sh.

Objektivat kryesorë të projektit për riparimet emergjente të punimeve civile për segmentit nr.1, Sauk – Hyrje, Tuneli i Kërrabës, janë sigurimi i rrjedhës së pandërprerë të trafikut lidhur me pjesën tjetër të rrugës Tiranë-Elbasan, tashmë të përfunduar; ulja e kostos operative të automjeteve; ulja e aksidenteve rrugore; kursimi i kohës së udhëtimit dhe realizimi i rritjes ekonomike në zonën e projektit.

Riparimi emergjent i punimeve civile do të lejojë, gjithashtu, vënien në përdorim të plotë të rrugës Tiranë-Elbasan, me gjatësi prej 27 km, për të lehtësuar trafikun, duke siguruar mundësi më të shpejtë arritjeje në zonat bregdetare, në terrenet malore dhe zonat rurale të Elbasanit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me Maqedoninë dhe Greqinë fqinje, duke rritur aktivitetet tregtare, tranzitin dhe turizmin në Shqipëri.

Nevoja për financim shtesë ka ardhur si rezultat i problematikave të shumta që janë hasur gjatë zbatimit të këtij projekti. Shkaktohet kryesore që kanë ndikuar në mosfinalizimin e projektit lidhen me problemet gjeologjike, e konkretisht, rrëshqitjet në km 11+100 (Ibë), km 13+150, km 14+000, si dhe lëvizjet gjeoteknike në zonën e Mulletit, km 4+000.

Bazuar në analizat financiare të gjendjes aktuale të fondeve, për përfundimin e plotë të veprës, bazuar në argumentet e paraqitura në relacionin shoqërues të projektligjit, do të duhet të akordohen fonde shtesë në vlerën prej 16 000 000 USD-sh.

Komponentet e kësaj marrëveshjeje janë si më poshtë:

- Punime civile për riparime. Ky komponent përfshin ri-profilizimin e sigurisë të skarpateve (punime për mbrojtjen e rrëshqitjes së dheut); stabilizimin e skarpateve dhe shtrimin e tubave të kullimit në zonat e paqëndrueshme; punime hidraulike voluminoze, duke përfshirë ndërtimin e kantiereve dhe kanaleve të kullimit dhe devijimit të lumenjve / rrymave, punë riparuese në strukturat e dëmtuara ekzistuese dhe ndërtimin e strukturës mbrojtëse që përfshin mure me pilota dhe mbushjen fundore.
- Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Konsulencës: ky komponent përshin financimin për studimet teknike të kryera, gjithashtu edhe shërbimet e konsulencës mbikëqyrëse.
- Menaxhimi i Projekti: ky komponent përshin financimin për shpenzimet e Njesisë së Menaxhimit të Projektit.

Për realizimin e punimeve civile emergjente është parashikuar një fond prej 14 860 000 USD-sh, nëpërmjet të cilit do të financohen punimet civile emergjente që do të kryhen për kompletimin e segmentit 1, me një gjatësi prej 13 km, të rrugës Tiranë-Elbasan, veçanërisht për përfundimin e rehabilitimit të rrëshqitjeve në km 4+000 (Mullet), km 11+000 (Ibë), km 12+000, km 13+150, km 14+150. Gjatësia totale e zonave problematike, ku është i nevojshëm përfundimi i rehabilitimit, është 4 km.

Për shërbimet e konsulencës është parashikuar vlera prej 1 100 000 USD-sh për periudhën kohore deri në dhjetor të vitit 2018, si dhe për një vit periudhë defektesh.

Për shpenzimet e njësisë së menaxhimit të projektit është parashikuar fond prej 40 000 USD-sh, i cili është i nevojshëm për periudhën e defekteve.

Afati për përdorimin e këtij financimi shtesë, që do të akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshje është deri në datën 31 dhjetor 2019.

Marrëveshja e huas është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr.502, datë 29.8.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me nenin 121 gërma “ç” të Kushtetutës dhe ligjin nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Anëtarët e Komisionit vlerësuan rëndësinë e kësaj projekt-marrëveshje për përfundimin e një prej akteve rrugore strategjike për ekonominë kombëtare siç është aksi Tiranë- Elbasan.

Nga ana e përfaqësuesve të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u sqarua se financimi shtesë, që po merret nëpërmjet kësaj marrëveshje huaje do sigurojë adresimin e problematikave të shumta që janë hasur gjatë zbatimit të këtij projekti si dhe do të bëjë të mundur finalizimin e projektit, me përjashtim ngjarjeve të forcës madhore.

Në përgjigje të pyetjeve të bëra nga deputetët, propozuesit shpjeguan se në shumën totale të huasë është përllogaritur edhe një fond rezervë për shpenzime të paparashikuara.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ADNOR SHAMETI

ULSI MANJA